

USHQYES KRISTALOR ME PERMBAJTJE TË LARTË
AZOTI ME MIKROELEMENTE TE ÇELATUAR ME EDTA



®



5 POUNDS
2.27 KG



®

NUTRI-
LEAF
30-10-10+TE



AZOT TOTAL(N)	30.0%	Bor (B)	0.02%
NO3: 3.0% NH4: 3.7%		Baker (Cu)	0.05%
Ureik	23.3%	Hekur (Fe)	0.10%
FOSFOR(P205)	10.0%	Mangan (Mn)	0.05%
POTAS(K2O)	10.0%	Molybden(Mo)	0.0005%
Magnez(Mg)	0.025%	Zink (Zn)	0.05%
Squfur(S)	1.9%		

PRODHUAR & PAKETUAR NË
SHTETET E BASHKUARA TË
AMERIKËS NGA

MILLER CHEMICAL & FERTILIZER, LLC

HANOVER, PENNSYLVANIA
17331 U.S.A.

“EC FERTILIZER”

Makroelementet derivojnë nga Ureja, Nitro Potasi, Fosfati i Amonit, Sulfati i Amonit, Fosfid Potasi Magnezi, Bakri, Hekuri. **Mikroelementet** : Manganezi dhe Zinku janë tërësisht të chelatuara me EDTA Chelate (Disodium Ethylenediamine Tetra Acetate Chelate). Bori i derivuar nga Sodium Borate. Molybdeni derivojnë nga Ammonium Molybdate, Squfur i derivuar nga Ammonium Sulfate.

NUTRI-LEAF 30-10-10® është një ushqyes gjethor dhe rrenjor me përqendrim të lartë të Azotit i balancuar me Fosfor dhe Potas. Përdoret në programet e ushqimit në të gjitha kulturat në ato fazat fenologjike dhe në ato kultura bujqësore kur Azoti kërket në sasi të konsiderueshme për të stimuluar zhvillimin vegetativ dhe rritur rendimentin. Përdoret gjithashtu për kurimin e shpejtë të karencës kur konstatohen shenjat e mungesës së Azotit.

DOZAT E PËRGJITHËSHME TË PËRDORIMIT: Në ushqimin gjethor përdoret 200-400 gr/100 lit. uje për të plotësuar programin normal të ushqimit rrenjor. Në trajtimeve zonale me pompe shpine përdoret 3 gr/lit. uje. Shtohet NU-FILM për të siguruar uniformitetin dhe ngjiteshmeri të solucionit përkatës në masën e gjelbër. **Në ushqimin rrenjor me ujtë me pika** përdoret 2-4 kg / dym. **KOHA, NUMRI I TRAJTIMEVE DHE SHPESHTIA E TYRE** : Rekomandohen 4-5 trajtime për sezon duke filluar nga rritja e vrulleshme e bimesës dhe perseritur në intervalin 7-10 dite. Numri dhe shpeshtia e trajtimeve është në vartësi të nevojave për Azot, të kushteve klimatike dhe streseve të ndryshme (mungesa e lageshtisë në tokë, temperaturat e larta, rreshjet e dendura dhe probleme fitopatologjike) të cilat mund të zvogëlojnë aftësinë e sistemit rrenjor në thithjen e lendeve ushqyese. **KUJDES:** Mos përdorni **NUTRI-LEAF 30-10-10®** në spërkatjet në fund të sezonit pasi ngjyra e frutit dhe pjekja vonohen nga aplikimi i azotit.

PERDORIMI :

NE PERIME : (Domate, Specat, Patllixhan, Kungull, Shalqi, Pjepër në fushe dhe Sera) : **Si ushqyes gjethor** me normën 0.5-1 kg/dym ose 200-400gr/100 lit uje. Aplikimi i parë duhet të bëhet 3 - 4 javë pas trajtimit. **Me ujtë me pika** përdoret 2-4 kg/dym. **PATATE:** **Si ushqyes gjethor** me normë 200-400 gr/100 lit. uje ose 5-10 kg/ha. Periudha me e mirë e përdorimit është midis ditës së 70 dhe 100 pas mbjelljes për të ritur peshën e tubereve. **NE VRESHTARI DHE MANORE:** **Si ushqyes gjethor** përdoret me normën 5-10 kg/ha në fillim të sezonit ose sa herë e shikojmë se bimesja ka nevojë për ushqim suplementar azot për fuqizimin e veshuleve dhe lastareve. **KUJDES:** Mos përdorni **NUTRI-LEAF 30-10-10®** brenda 60 ditëve nga pjekja pasi ngjyra dhe pjekja e frutit do të vonohen nga aplikimi i azotit. **FRUTIKULTURE :** **Në ushqimin gjethor** me normën 200-400 gr/100 lit. uje ose 5-10 kg/ha (0.5-1 kg/dym) në vartësi të fazës bimërore dhe masës vegetative. Aplikohet herët në sezonin e rritjes ose sa herë është e nevojshme për ushqim shtesë Azotik. **LULESHTRYDHE:** **Si ushqim gjethor** përdoret me normën 0.5-1 kg/dym kur sythat e parë të frutave shfaqen në kurorë. **Si ushqyes rrenjor** me sistemin e ujtës me pika rekomandohet 2-4 kg/dym. **NE BIMET E ARAVE DHE FORAGJERE:** **Si ushqyes gjethor** me normën 5-10 kg /ha. në fazën e rritjes së vrulleshme për nxitjen e masës vegetative dhe rritjen e rendimentit. **NE DUHAN:** Kryhen trajtime gjethore me normë 200-400 gr/100 lit. uje duke filluar në fazën e rritjes së vrulleshme. **NE PERIMET GJETHORE** dhe **BISHTAJORE** (Fasule, Bizele) : Përdoret si ushqyes gjethor me doza 200-400 gram për 100 litra uje duke filluar 3 javë pas mbjelljes.

VEREJTJE PËR PËRDORIMIN : Përputhshmëria: **NUTRI-LEAF 30-10-10®** përzihet me insekticidet dhe fungicidet të cilat janë në përdorim të gjerë në Perimet, Frutat, Bimë arash, Lulet dhe Bimë Dekorative. **KUJDES:** **NUK** përzihet me Grupin Dinitor, Bordolezin e pregatitur në fushe, Polisulfure, NitroKalcium ose materiale shumë alkaline. Në perzierje me produkte të tjeër **NUTRI-LEAF 30-10-10®** gjithmonë hidhet në depozitën e spërkatjes si përbërës i fundit. Kur përdoret ujë shumë i ftohtë, perzierjesin duhet të zgjasë disa minuta me shumë për të siguruar tretjen e plote të produktit. **SHENIM :** Përdorni këtë produkt në përputhje me praktikën e mira agronomike, të cilat përfshijnë përdorimin e pajisjeve përkatëse cilësore për të garantuar mbulimin uniform të gjetheve. Mos trajtoni kur temperaturat janë shumë të nxehta. Trajtimet duhet të bëhen në temperatura të moderuar vone mbasdite dhe në kushte të tjera mjedisore të zonave, të cilat nga përvoja juaj garantojnë efektivitetin e spërkatjes dhe rezultatin e dëshiruar. **RUAJTJA DHE MAGAZINIMI :** Produkti ruhet në ambalazh origjinal, në vende të fresketa dhe të thata në temperatura -5 / +50°C larg rezeve direkte të diellit. Periudha maksimale e ruajtjes në këto kushte është e pakufizuar. **MBAHENI LARG ARITJES PREJ FEMIJEVE.**

E RENDESISHME : Duke qenë se **NUTRI-LEAF 30-10-10®** përdoret jashtë kontrollit tonë dhe duke pasur parasysh se ky produkt përmban elemente të rreziku për njerëzit, kafshët dhe bimësinë, ne nuk japim asnjë garanci, të shprehur apo të nënkuptuar, për sa i përket efekteve negative në njerëz, kafshë dhe bimësi, kur ky produkt nuk përdoret në përputhje me udhëzimet e deklaruar në këtë etiketë.

NUTRI-LEAF 30-10-10® është markë e regjistruar e
Miller Chemical & Fertilizer, LLC

DISTRIBUTOR PËR SHQIPËRI : AGROHELP SHPK
DURRES , CEL : 00355 692055 309/310

